



Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve

PLAN VEPRIMI

Për realizimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve

2019

Mbështetur dhe miratuar nga Bordi i Akreditimit

Përmbajtja

Hyrje	3
1. Aktivitete të zhvilluara gjatë periudhës 2017 - 2018	3
2. Situata aktuale dhe hapat për realizimin e SKS në vitin akademik 2018 - 2019	4
2.1. Faza e parë.....	4
2.2. Faza e dytë.....	5
2.3. Faza e tretë	5
3. Plani i detajuar i aktiviteteve, afatet kohore të propozuara	5
4. Infrastruktura, logjistika dhe kostot financiare të nevojshme për realizimin e procesit ...	8

Hyrje

Bazuar në ligjin nr. 80/15, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë", një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS).

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë dhe Bordi i Akreditimit vlerësojnë çdo tre vjet ose në periudha ndërmjetëse, vlerësime specifike në kuadër të analizave kombëtare në arsimin e lartë, për politikëbërjen etj. SKS bazohet në opinionin individual të studentëve për institucionet dhe në përfundim të tij hartohet raporti analitik me rezultatet e pyetësorëve për çdo IAL, shoqëruar me analizat përkatëse si dhe analiza krahasuese për indikatorë të ndryshëm përkundrejt interesit publik apo të politikëbërjes. Raporti dhe rezultatet bëhen publike për informimin e studentëve.

1. Aktivitete të zhvilluara gjatë periudhës 2017 - 2018

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, bazuar në nenin nr. 104 "Sigurimi i jashtëm i cilësisë", të Ligjit 80/2015, ka kryer një sërë aktivitetesh në kuadër të zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

Në bashkëpunim me Bordin e Akreditimit, në korrik 2017 është ngritur Grupi i Punës për analizën (me përbërje nga ASCAL dhe BA), vlerësimin dhe përgatitjen e metodologjisë, draft-pyetësorit përkatës dhe të infrastrukturës/logjistikës për realizimin e SKS.

Grupi i Punës në këtë kuadër, përgatiti *Manualin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve* dhe *"Pyetësorin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve"*, të cilat u shqyrtuan dhe miratuan me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 2, datë 30.03.2018.

Po ashtu, Grupi i Punës përgatiti versionin paraprak të SKS në të cilin janë përcaktuar fushat e vlerësimit, indikatorët dhe treguesit e matshëm.

ASCAL, gjatë periudhës janar - prill 2018 ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me Institucionet e Arsimit të Lartë për nisjen e procedurës për zhvillimin e SKS.

Janë njoftuar zyrtarisht titullarët e institucioneve për zhvillimin e SKS dhe njëkohësisht u është kërkuar institucioneve të përgatisin listat e studentëve me kontaktet e tyre dhe ti dërgonin ato në ASCAL.

Është organizuar nga ASCAL dhe BA një takim informimi me drejtuesit e Këshillave studentore për ti informuar rreth SKS dhe për te marre mendimin e tyre.

Procesi është ndërprere në këtë fazë pasi gjatë kësaj periudhe, në institucionet publike janë zhvilluar zgjedhjet për ngritjen e Këshillave Studentore në përputhje me ligjin 80/2015.

Meqenëse, bazuar në Manualin për zhvillimin e SKS, bashkëpunëtorët kryesorë të procesit janë studentët dhe strukturat e tyre, ky proces është konsideruar i pa mundur të zhvillohej deri në përfundim të riorganizimit të këtyre strukturave.

Faktor tjetër i rëndësishëm për mosfillimin e procesit në vitin 2017-2018, ka qenë mungesa e mbështetjes së ASCAL në disa aspekte: mosmiratimi i strukturës dhe organikës së ASCAL që parashikonte dhe staf të specializuar për këtë qëllim, mosmiratimi nga MASR dhe MF e skemës së përdorimit të të ardhurave të ASCAL që do mundësonte mbështetjen logjistike teknike dhe infrastrukurore dhe kushtet e papërshtatshme të mjediseve ku ushtron veprimtarinë ASCAL.

Pavarësisht se disa IAL kanë vënë në dispozicion kontaktet e studentëve si dhe kanë informuar studentët për njohjen me procesin, kjo fazë duhet të zhvillohet nga e para.

2. Situata aktuale dhe hapat për realizimin e SKS në vitin akademik 2018 - 2019

ASCAL si institucioni përgjegjës që harton procedurën, metodologjinë, instrumentet dhe zhvillon SKS, planifikon periudhën dhe afatet për realizimin e SKS.

Bazuar në Manualin për zhvillimin e SKS, harton planin e detajuar dhe ja propozon BA për t'u miratuar dhe zhvilluar në vitin pasardhës. Plani i aktiviteteve i hartuar ka nevojë të rishikohet dhe përshtatet për vitin e ri akademik. Bazuar në Manualin e SKS, është i nevojshëm hartimi i procedurës së posaçme për zhvillimin e SKS në vitin akademik 2018 – 2019. Duhet të rishikohen dhe përshtaten fushat, indikatorët dhe treguesit duke patur parasysh Kodin e Cilësisë si dhe ndryshimet në vitin e ri akademik si rrjedhojë e hyrjes në fuqi të disa akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.

Zhvillimi i SKS kërkon angazhim maksimal pasi është një proces që përfshin mjaft aktorë dhe që zhvillohet për një kohë të gjatë.

Në bazë të përcaktimeve të Manualit, për zhvillimin e sondazhit kombëtar të studentëve propozohen këto faza:

2.1. Faza e parë

Bazuar në Manualin e SKS, titullari i ASCAL nis procedurën për hartimin Projekt propozimin për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studenteve. Në këtë kuadër mund të kërkohet edhe angazhimi i ekspertëve të fushës të cilët asistojnë ASCAL në përgatitjen e projektit me periudhën e aktivitete të detajuara.

Për këtë arsye, periudha më e përshtatshme për hartimin dhe miratimin e planit të aktiviteteve në kuadër të SKS është **shtator – tetor të vitit paraardhës**. Plani i detajuar i **dorëzohet për shqyrtim** Bordit të Akreditimit.

BA pasi shqyrton planin e propozuar, miraton ose propozon ndryshime eventuale të tij. Në çdo rast, BA **me vendim të posaçëm**, miraton planin dhe kalendarin e aktiviteteve dhe ngarkon ASCAL për zhvillimin e tij. Agjencia **bën publik** planin e miratuar.

2.2. Faza e dytë

Pas miratimit të planit të aktiviteteve, titullari i ASCAL **ngre Grupin e Punës (GP)** dhe **cakton koordinatorin** për zhvillimin e SKS, **informon institucionet** e arsimit të lartë, qeveritë dhe/ose këshillat studentore dhe **bën publik planin e detajuar** të aktiviteteve.

GP, bazuar në Manualin për zhvillimin e SKS, **harton procedurën** e zhvillimit të SKS. Gjatë kësaj faze hartohen dhe miratohen fushat dhe pyetëtorët. ASCAL dhe GP është përgjegjës për zhvillimin e SKS në përputhje me procedurën e miratuar. Për këtë arsye ASCAL **garanton ecurinë** e procesit duke vënë në dispozicion të GP, **infrastrukturën e nevojshme logjistike**, burimet njerëzore dhe financiare.

Pas miratimit të procedurës së zhvillimit të SKS sondazhit të studentëve, GP harton **dokumente trajnimi** dhe **trajnojnë** studentët në institucionet e arsimit të lartë në bazë të një kalendari të miratuar paraprakisht.

Po ashtu, gjatë kësaj faze përgatitet **versioni on line** i sondazhit në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), mblidhen **të dhënat dhe kontaktet** e studentëve nga koordinatorët e IAL. Krijohen llogaritë për akses personal për të gjithë studentët që marrin pjesë në sondazh dhe bëhen testet paraprake të funksionimit të tij.

Pasi sigurohet funksionimi i plotë, **nis shpërndarja** e pyetësorit on line për studentët duke lënë aktiv llogaritë e studentëve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e aktiviteteve.

E gjithë kjo fazë e rëndësishme kërkon angazhimin e të gjithë stafit të ASCAL, ekspertëve si dhe infrastrukturë të posaçme për garantimin e procesit.

2.3. Faza e tretë

Faza e tretë është faza finale e procesit e cila nis **me mbylljen e aksesit** në pyetësor. GP përgatit **infrastrukturën** për mbledhjen e të dhënave nga pyetësorët e plotësuar, **shkarkon** të dhënat dhe **bën filtrimet** e duhura në databazë. Më pas **kryhen përpunimet statistikore** sipas përcaktimeve të Manualit si dhe **përgatit materialet** me rezultatet paraprake, përgatit **raportet përmbledhëse** e analitike si dhe harton **raportin final** me rezultatet përfundimtare të procesit, **informon** ASCAL dhe BA, **bën publike** rezultatet dhe **përmbyll procesin**.

3. Plani i detajuar i aktiviteteve, afatet kohore të propozuara

Aktivitetet e propozuara në secilën fazë të zhvillimit të SKS, me datat dhe afatet përkatëse jepen në tabelën e mëposhtme:

Fazat e zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve	
Viti akademik 2018 - 2019	
Fillimi / Kohëzgjatja	Aktivitetet që zhvillohen
05 – 18 Janar 2019	<ul style="list-style-type: none">• Titullari i ASCAL nis procesin për realizimin e SKS për vitin akademik 2018 – 2019.• Nis puna për hartimin e Projekt propozimit për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studenteve.

		<ul style="list-style-type: none"> • Angazhohen ekspertë të fushës të cilët asistojnë ASCAL në përgatitjen e projektit me periudhën e aktivitete të detajuara.
FAZA II	18 Janar – 01 Shkurt 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Plani i detajuar i dorëzohet për shqyrtim Bordit të Akreditimit. • BA shqyrton planin e propozuar, miraton ose propozon ndryshime eventuale të tij. • BA me vendim të posaçëm, miraton planin dhe kalendarin e aktiviteteve dhe ngarkon ASCAL për zhvillimin e tij. • Agjencia bën publik planin e miratuar. • Titullari i ASCAL ngre Grupin e Punës dhe cakton Koordinatorin e procesit
	1 Shkurt – 28 Shkurt	<ul style="list-style-type: none"> • ASCAL & BA zhvillojnë takime me titullarët e institucioneve / Rektorët për fillimin e procesit për SKS dhe njohjen me qëllimin e tij • ASCAL informon institucionet e arsimit të lartë, qeveritë dhe/ose Këshillat studentore • Bazuar në Manualin për zhvillimin e SKS, hartohet dhe miratohet procedura e zhvillimit të SKS. • Hartohen dhe miratohen fushat dhe pyetësorët. • ASCAL siguron infrastrukturën e nevojshme logjistike, burimet njerëzore dhe financiare.
	28 Shkurt– 22 Mars	<ul style="list-style-type: none"> • Hartohen dokumente trajnimi • Kontaktohen koordinatorët e institucioneve, drejtuesit e këshillave studentore • Kërkohen kontaktet e studentëve, Dip_2vj.(v2), BSc.(v2,v3), Mp, MSc.(v1,v2) • Hartohet kalendari i trajnimeve për studentët në institucionet e arsimit të lartë dhe informohen drejtuesit e studentëve dhe KI • Diskutohen me këshillat studentorë fushat dhe indikatorët e SKS • Reflektohen propozimet eventuale të KS kur ato janë të vlefshme dhe finalizohet versioni final i SKS.
	22 Mars – 12 prill	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnohen studentët për mënyrën e plotësimit, qoftë me takime përmbledhëse apo vizita në institucione të caktuara sipas kërkesave nga IAL dhe planit paraprak. • Kontaktohen koordinatorët e institucioneve për bashkëpunim me studentët dhe informimin e tyre • GP dhe ASCAL përgatit infrastrukturën logjistike (për sondazhin on line)

	13 prill – 20 maj	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitet versioni <i>online</i> i SKS në shqip • Përgatitet versioni <i>online</i> i SKS në anglisht • Përgatiten formatet e komunikimeve me studentët dhe vendosen afatet on line • Kryhen testet e nevojshme, • Krijohen llogaritë për akses individual on line etj
	20 Maj – 20 Qershor	<ul style="list-style-type: none"> • Njoftohen paraprakisht këshillat studentorë dhe koordinatorët e IAL për shpërndarjen e pyetësorëve • Shpërndahen pyetësorët, • GP /ASCAL ndjek ecurinë e plotësimit të sondazhit • Asiston studentët në zgjidhjen e problematikave të ndryshme
FAZA III	20 Qershor – 30 Qershor	<ul style="list-style-type: none"> • Mbyllet aksesi <i>online</i>, • Mblidhen të dhënat dhe bëhen filtrimet e mundshme • Përgatiten të dhënat për përpunime statistikore
	30 Qershor – 15 Korrik	<ul style="list-style-type: none"> • GP përgatit infrastrukturën për përpunimet statistikore sipas përcaktimeve të Manualit • Nxirren rezultatet individuale për çdo IAL • Hartohen tabelat përmbledhëse për analiza krahasuese për indikatorë të ndryshëm
	15 Korrik–10 Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatiten dhe finalizohen rezultatet individuale për çdo IAL • Përgatiten informacione shtesë për IAL dhe së bashku me rezultatet e sondazhit për çdo fushë, indikator dhe pyetje bëhen pjesë e raporteve apo për publikohen
	10 Gusht – 25 Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • Hartohet raporti përmbledhës për të gjitha IAL me rezultate krahasuese për fusha dhe indikatorë të veçantë. • Analizohet cilësia e mësimdhënies në bazë të rezultateve, • Nxirren konstatime dhe problematika • Propozime nga GP për përmirësime në të ardhmen
	26 Gusht – 13 Shtator	<ul style="list-style-type: none"> • Hartohet raporti final (Përmbledhja e të gjitha informacioneve të nevojshme për shqyrtim, përfshirë metodologjinë, ecurinë e plotë, rezultatet individuale dhe raportin përmbledhës). • Dokumentacioni i plotë shqyrtohet nga BA në mbledhjen e radhës që zhvillohet në këtë periudhë. • BA analizon rezultatet, përfundimet, gjetjet, propozimet dhe merr vendime respektive • GP dhe ASCAL përgatisin platformën dinamike on line për publikimin e rezultateve për kërkim interaktiv • ASCAL publikon të gjitha raportet, rezultatet dhe

		vendimet e BA
	16 Shtator – 30 Shtator	<ul style="list-style-type: none"> Raportet dërgohen zyrtarisht në IAL dhe në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë, së bashku me vendimmarrjen dhe rekomandimet përkatëse Mbyllet procesi i zhvillimit të SKS dhe arkivohet informacioni / dokumentacioni

4. Infrastruktura, logjistika dhe kostot financiare të nevojshme për realizimin e procesit

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, është institucioni përgjegjës për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve. Meqenëse në VKM nr. 109, datë 15.02.2017, *Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë*, nuk janë përcaktuar modalitetet me të cilin ASCAL do të zhvillojë këtë proces.

SKS zhvillohet për herë të parë në vendin tonë dhe ky proces do të konsiderohet si projekt pilot për të zhvilluar më tej mekanizma, infrastrukturë, gjetjen e fondeve financiare etj.

SKS për vitin 2018 – 2019, do të mbulohet tërësisht nga të ardhurat e ASCAL pasi nuk është parashikuar tarifë shërbimi për IAL apo zë i veçantë në mbështetje të buxhetit të ASCAL.

Po ashtu, infrastruktura logjistike e ASCAL, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme drejtuar MASR, nuk është në nivelin e duhur që të përballojë këtë proces nëse nuk garantohet infrastruktura e nevojshme.

Bazuar në analizën paraprake të kryer nga ASCAL dhe ekspertë të fushës, për zhvillimin e SKS 2018 – 2019, janë të nevojshme:

Personel & Logjistika	Numër	Kosto (lekë)
Stafi i ASCAL i nevojshëm për procesin	4	-
Kopjuterat Personalë	4	260000
Laptopë	4	300000
Projektorë	2	100000
Programe të licencuara (M Office, SPSS etj)	4 x 2 = 8 licenca	prokurim
Server HD (Upgrade HD)	2 x 2 TB	76000
Kontratë me kompani hostimi për hostimin e sondazhit dhe mundësi të dërgimit të e-maileve me numër të lartë	Shtesë kontrate me ABCOM	prokurim

Kontratë me kompani për përgatitjen e portalit on line në versionin dinamik me kërkim të personalizuar për publikim të rezultateve	Programim të portalit dhe asistencë teknike për 1 vit	1500 - 3000 euro
Ekspertë të fushës me eksperiencë në përgatitjen, administrimin dhe përpunimin e rezultateve të sondazheve	Angazhim ekspertë të jashtëm të fushës	100, 000 lekë
Takim me Rektorët / Koordinatorët e IAL	1 takim	Kosto salle
Trajnime me studentët (kosto, salle, printime materialesh etj)	4 takime	Kosto salle
Transport të stafit në trajnime	2 grupe paralele	Karburant, tjetër